



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.135/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Nenad Lazić dhe Afijete Sada Glllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore, Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e paraqitur nga Koalicioni Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Partia e Drejtësisë (PD), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), në Prishtinë, për mbajtjen e tubimit politik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 02.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.96/2019 i datës 26.09.2019, i paraqitur nga Koalicioni Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Partia e Drejtësisë (PD), me seli në Prishtinë, kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK dhe Partia Socialdemokrate (PSD)), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që ti lejohet mbajtja e tubimit publik me datë 03.10.2019, në Pallatin e Rinis në Prishtinë, në sallën e sporteve.

A r s y e t i m

Me datën 30.09.2019, Koalicioni Nisma-AKR-PD, ka paraqitur apel në PZAP, me të cilin pretendojnë KKZ-ja në Prishtinë, ju ka bërë padrejtësi me rastin e kthimit të përgjigjes negative lidhur me kërkesën që e ka bërë ankuesi te KKZ-ja, për rezervimin e sallës në Pallatin e Rinisë, respektivisht në sallën e sporteve, për mbajtjen e tubimit publik me datë 03.10.2019. Me propozim për panelin që të aprovohet apeli dhe ti lejohet mbajtja e tubimit publik gjatë fushatës zgjedhore me datën 03.10.2019, në Pallatin e Rinisë, respektivisht në sallën e sporteve.

Në përgjigje në apel KQZ dhe KKZ, theksojnë se në bazë të Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013, Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike, neni 4 paragrafi 2, subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë dhe të mbajë një tubim politik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, duhet që të Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve, i asaj komune (ZLKZ) ta dorëzojë formularin e plotësuar të Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik (FNjMTP), më së voni shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara.

Në përgjigjen e Koalicionit AAK- PSD, theksohet koalicioni AAK – PSD, ka zbatuar rregullën zgjedhore Nr. 13/2013 neni 4 paragrafi 2, me pretendim se pala ankuese ka bërë ankesë të

padrejtë ndaj tyre. Koalicioni AAK-PSD kërkon nga PZAP-i, që të marrë për bazë veprimet e AAK PSD që është paraparë në Rregulloren Nr.11/2013 neni 3 alinea 3.3,3.4 dhe 3.6 për thirrjen dhe lajmërimin e të gjitha strukturave dhe mbështetësve që ta respektojnë ligjin në fuqi dhe rregulloren e kodit të mirësjelljes. Po ashtu kërkon nga PZAP-i që ta refuzon ankesën si të pabazuar dhe të njëjtit ti tërhiqet vërejtja për abuzim me të drejtën e ankesës së paraparë në kodin zgjedhor.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit dhe shkresave tjera të lëndës, paneli gjeti se **apeli është i pabazuar**, për këto arsye:

Paneli vlerëson se KKZ-ja, në Prishtinë, ka vepruar drejtë kur e ka njoftuar ankuesin se me datë 03.10.2019, nuk mund ta shfrytëzojnë sallën e sporteve të Pallati i Rinis, në Prishtinë, për mbajtjen e tubimit publik, për fushatën zgjedhore sepse sipas nenit 4 paragrafi 3 pika b), të Rregullës Zgjedhore 13/2013, ZLKKZ-ja, do ti jep përparësi atij subjekti politik që e ka dorëzuar kërkesën - FNjMTP, i pari dhe ta refuzojë kërkesën që është paraqitur nga subjekti politik më vonë. Në këtë rast rezulton nga shkresat e lëndës se kërkesën së pari për mbajtjen e tubimit publik e ka paraqitur, për vendin, datën dhe kohën e njëjtë Koalicioni AAK – PSD, me datën 21.09.2019, ndërsa koalicioni NISMA, AKR dhe PD, kërkesën për mbajtjen e tubimit publik në KKZ, e kanë paraqitur me datë 27.09.2019, andaj pretendimet e ankuesit janë në tërësi të pabazuar.

Pretendimet e ankuesit, se ka lidh Kontratës me N.P.L Pallati i Rinisë, Sh.A, për shfrytëzimin e objektit për mbajtjen e tubimit publik, nga paneli vlerësohen se këto pretendime janë pa ndikim për te vendosur ndryshe në këtë rast sepse koalicioni Nisma, AKR dhe PD, paraprakisht është dashtë të bëjnë kërkesë-njoftim në KKZ, për mbajtjen e tubimit publik dhe pas aprovimit nga KKZ-ja dhe Policia e Kosovës, do mund të procedojnë mëtej, ngase kontrata e lidhur para se të lejohet mbajtja e tubimit publik nga KKZ-ja, është në kundërshtim me neni 4 të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 i LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 135/2019 më datë 02.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*